AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Dhjetor 2023

11.01.2024
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin Dhjetor 2023, viti bazë 2015=100.

Çmimet e konsumit shkuan në 4,9% për vitin 2023

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 4.9% në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.

Viti 2023 / Viti 2022 4,9%

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit në vend në vitin 2023 ishte më i lartë në një mesatare prej (4,9 %) krahasuar me vitin 2022.
Ngritja e indeksit të çmimeve të konsumit është vërejtur te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: perimet (15,9%), pemët (11,4%), prodhimet ushqimore (11,3%), sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe ëmbëlsirat (11,2%), buka dhe drithërat (8,9%), qumështi, djathi dhe vezët (8,4%), mishi (7,8%), energjia elektrike gaz dhe lënde djegëse te tjera (7,5%), mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtja e shtëpisë (7,3%), strehimi , uji, energji elektrike, gazi dhe lëndë djegëse të tjera (6,4%), pijet alkoolike, duhani (6,4%), pijet joalkoolike (6,3%), restorantet dhe hotelet (5,8%), mallra dhe shërbime te ndryshme (3,8%), blerja e automjeteve (3,8%), veshje dhe këpucë (3,4%), shëndetësia (2,7%) me një ndikim te përbashkët te këtyre nëngrupeve prej 6,2 përqindja në IHÇK-it.
Ndërsa rënie e indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit gjatë vitit 2023 është vërejtur te nëngrupe e COICOP-it: karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-11,4%), përdorimi i pajisjeve të transportit personal (-8,3%), transporti (-2,2%) me një ndikim te përbashkët prej -1,3 për qind në IHÇK-it.

Dhjetor 2023 / Dhjetor 2022 2,3 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej (2,3 %) në muajin Dhjetor 2023 krahasuar me muajin Dhjetor 2022.

Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: pemët (16,6%), perimet (16,4%), pajisje terapeutike (6,9%), sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe ëmbëlsirat (6,6%), pijet alkoolike, duhani (6,5%), mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve personale te transportit (6,5%), prodhimet ushqimore (6,3%), qelqurinat , takëmet dhe mjetet e kuzhinës (5,8%), restorantet dhe hotelet (3,9%), produktet mjekësorë aparature dhe pajisje (3,6%), shërbimet ambulatore (3,4%), buka dhe drithërat (2,4%), mallrat dhe shërbimet e ndryshme (2,4%), veshje dhe këpucë (2,0%), gazi (2,0%), shërbimet financiare (1,8%), mishi (1,3%), mobilje dhe orendi qilima dhe mbulesa te tjera dyshemeje (1,1%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2,7 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: vajrat dhe yndyrat (-10,5%), qumështi, djathi dhe vezët (-3,7%), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj (-0,9%), mjetet e komunikimit (-0,4%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,4 për qind në IHÇK-it.

Dhjetor 2023 / Nëntor 2023 0,3 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare 0,3% në muajin Dhjetor 2023 krahasuar me muajin Nëntor 2023. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të artikujve dhe shërbimeve te grupet dhe nëngrupet e COICOPI-it: shërbimet për transport (16,7%), energjia elektrike (10,3%), perimet (2,6%), duhani (1,7%), qumështi, djathi dhe vezët (1,7%), pajisjet shtëpiake (0,4%), pijet joalkoolike (0,2%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,9 për qind në IHÇK-it.
Ndërsa rënia e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-6,0%), buka dhe drithërat (-0,8%), shëndetësia (-0,2%), veshje dhe këpucë (-0,1%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,6 për qind në IHÇK-it.

Norma mujore dhe vjetore e inflacionit në % të matura nga IHÇK



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në % për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it, Kosovë

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat 2023 në ‰	XII - 2023 2015=100	XII - 2023 XI- 2023	XII - 2023 XII - 2022	Indeksi mesatar vjetor 2023, 2015=100	2023 2022
00	Gjithsej IHÇK	1000,0	129,8	0,3	2,3	128,0	4,9
01	Ushqimi dhe pijet joalkoolike	381,9	143,3	0,4	3,0	142,1	8,4
02	Pijet alkoolike, duhani	64,4	138,8	1,3	6,5	135,1	6,4
03	Veshje dhe këpucë	41,1	107,5	-0,1	2,0	105,7	3,4
04	Strehimi , uji, energji elektrike, gazi dhe lëndë djegëse të tjera	89,4	129,1	4,2	5,9	120,3	6,4
05	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	62,0	120,8	0,2	4,3	119,0	7,3
06	Shëndetësia	24,1	116,4	-0,2	3,3	114,9	2,7
07	Transporti	182,9	122,0	-1,8	-3,4	122,9	-2,2
08	Mjetet e komunikimit	21,9	114,5	0,0	-0,4	114,5	-0,5
09	Rekracioni dhe kultura	36,6	106,1	-0,1	4,8	103,7	2,9
10	Arsimi	5,9	104,0	0,0	-0,3	104,6	1,9
11	Restorantet dhe hotelet	32,1	129,3	0,0	3,9	127,8	5,8
12	Mallrat dhe shërbimet e ndryshme	57,8	118,6	0,2	2,4	117,2	3,8

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin Dhjetor 2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/ekonomi/cmimet